REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.52, datë 16/09/2005

"PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "ANGAZHIMI NË PUNË TË PËRKOHSHME NË KOMUNITET TË PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË SKEMËN E NDIHMËS EKONOMIKE, NË MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E SIPËRFAQEVE TË GJELBËRUARA NË NJËSITË BASHKIAKE NR. 5 DHE NR. 6".

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 11, pika 3/c dhe ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", neni 4, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.758, dt.13/11/2003, "Për pilotimin e shpërndarjes së fondeve të ndihmës ekonomike, të kushtëzuar me punë dhe shërbime në komunitet", ligjit Nr.9355, dt.10/03/2005 "Për ndihmën dhe shërbimet sociale" neni 17, pika 1, neni 21 dhe neni 37, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005" dhe me propozimin Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë projektin "**Angazhimi në punë të përkohëshme në komunitet, të personave të përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara në Njesitë Bashkiake Nr. 5 dhe Nr. 6 të Tiranës"**.

2. Efektet financiare të këtij projekti do të përballohen duke pakësuar Buxhetin e Bashkisë së Tiranës, për vitin 2005, në shumën 3.486.760 lekë, në zërin "Projekte Sociale", e duke shtuar buxhetin e Njësive Bashkiake Nr.5 dhe Nr.6, për vitin 2005, në zërin "Projekte Sociale" me shumën;

Njësia Bashkiake Nr. 5	**1 983 000 lekë**
Njësia Bashkiake Nr. 6	**1 503 760 lekë**

3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar dhe Njësitë Bashkiake Nr.5 dhe Nr. 6, për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI